



RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Me pasqyrat financiare të audituara

Viti fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2016

PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË

Sheshi "Austria", Tiranë

Subjekti - Partia politike

PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË

Adresa: Sheshi "Austria", Tiranë

Audituar nga:

Marije DUSHI - Partner

"FICADEX ALBANIA" Ltd

"Migjeni" street, 147 Q. 4, Durrës - Albania;

Tel/fax + 355 52 37 839

Misioni

Auditimi i Pasqyrave financiare të Partisë për vitin 2016

Raporti

Data 24 Tetor 2017

Versioni: Final

Deklaratë përgjegjësie

Partia "PS" ka hartuar dhe dorëzuar në KQZ dhe Tatime (DRTT) pasqyrat financiare për vitin 2016 të kërkuara nga legjislacioni në zbatim të ligjit ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 (i ndryshuar)"Për krijimin e Partive Politike"; SKK për OJF-të; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe legjislacionit fiskal.

I gjithë dokumentacioni dhe regjistrat e audituar janë paraqitur nga drejtimi i Partisë dhe Opinioni ynë është bazuar vetëm në plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit, fakteve, supozimeve dhe prezantimeve që na u vunë në dispozicion. Është rënë dakord, që për arsye të rëndësisë në punën tonë, të informacionit dhe përfaqësimeve që na janë dhënë nga Partia, drejtuesit e saj, punonjësit apo agjentët, ne nuk jemi përgjegjës ose fajtorë në qoftë se informacion i rëndësishëm na është mbajtur i fshehur me qëllim, ose i përfaqësuar me mashtrim për ne.

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur

me

Pasqyrat financiare të partisë, të audituara

- ♦ Pasqyra e pozicionit financiar për vitin fiskal që përfundon në 31.12.2016 (rideklaruar);
- ♦ Pasqyra e aktiviteteve (performancës financiare) për vitin fiskal që përfundon në 31.12.2016 (rideklaruar);
- ♦ Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin fiskal që përfundon në 31.12.2016 (rideklaruar);
- ♦ Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto (rideklaruar)

Përmbajtja e shënimeve

- Informacion i përgjithshëm	1
- Kuadri i përgjithshëm për përgaditjen e pasqyrave financiare	2
- Parimet bazë për përgaditjen e pasqyrave financiare	2.1
- Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare	2.2
- Përkufizimet kryesore për elementët e pasqyrave financiare të OJF-ve	2.3
- Politikat kontabël	3
- Korigjimi i gabimeve	4
- Ngjarje pas përfundimit të periudhës raportuese	5
- Analiza e posteve të pasqyrës së pozicionit financiar	6
- Pasqyra e aktiviteteve	7

Skeda suplementare për pasqyrat financiare:

- Aneksi A - tabela e dhurimeve



RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë

"PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË"

Sheshi "Austria", Tiranë

Raport për auditimin e pasqyrave financiare

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur, paraqesin drejt në të gjithë aspektet materiale, pozicionin financiar të Partisë "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" ("PS") më 31 Dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e saj të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me standardin kombëtar të kontabilitetit për OJF-të; "Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" i miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015; si dhe Ligjin Nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011; ligjin nr. 17/2014, datë 20.2.2014 dhe ligjin nr. 25/2014, datë 25.9.2014.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Partisë "PS", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar i datës 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e aktiviteteve (performancës) dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet mbi pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme.

Bazat për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më me detaje në seksionin e raportit tonë "përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare". Ne jemi të pavarur nga Partia në përputhje me Kodin e Etikës të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Theksimi i Çështjes

- Pasqyrat financiare janë përgatitur për të asistuar Partinë Socialiste të Shqipërisë "PS" për të përmbushur kërkesat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë dhe të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Si rezultat, pasqyrat financiare të Partisë nuk mund të jenë të përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër.
- Auditimi i pasqyrave financiare për vitin që përfundon në 31.12 2015 është kryer nga një auditor tjetër.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në përputhje me SKK-të; "Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" i miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015; si dhe Ligjin Nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011; ligjin nr. 17/2014, datë 20.2.2014 dhe ligjin nr. 25/2014, datë 25.9.2014 dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Partisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion shpjegues, kur është e aplikueshme, çështjet që lidhen me vijimësinë duke përdorur bazën kontabël të vijimësisë nëse menaxhimi nuk synon likuidimin ose të ndërpresë operacionet, ose kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër realiste por vetëm të veprojë në këtë mënyrë.

Përgjegjësia e personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Partisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat e auditimit tonë janë të marrim siguri të arësyeshme nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak mashtrimi apo gabimi, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsësyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të shkaktohen nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet në mënyrë të arësyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Një përshkrim i mëtejshëm i përgjegjësive tona për auditimin e pasqyrave financiare është përfshirë në shtojcën "A" të këtij raporti të audituesit, i cili gjendet në faqen nr. 3 në vijim.

Raport mbi kërkesat dhe rregullat e tjera ligjore

Për vitin ushtrimor që përfundon në 31.12.2016, Partia Socialiste e Shqipërisë nuk ka marrë dhe nuk ka raportuar dhurime nga personat fizik (përfshirë edhe shtetasit shqiptar me banim jashtë territorit shqiptar) ose juridik, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" (i ndryshuar) dhe "Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" i miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 (i ndryshuar).

Në mungesë të ekzistencës së dhurimeve, ne nuk kemi qenë në kushtet e auditimit për saktësinë e raportimit të dhurimeve dhe përputhjen me kërkesat e Ligjit Nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" (i ndryshuar), "... për raportimet financiare vjetore" dhe "Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" i miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 (i ndryshuar) "... për deklarimet nga partitë".

Për këtë arsye ne nuk mund të shprehim opinion auditimi për dhurimet.

Objektivi kryesor i kësaj pjese të auditimit është të japim një opinion nëse Partia Socialiste e Shqipërisë ka raportuar dhurimet saktësisht dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit mbi Partitë Politike (për raportimet financiare vjetore) dhe Kodit Zgjedhor (për deklarimet nga partitë).



"FICADEX ALBANIA" SHPK

L. 4, Rr. Migjeni nr. 147, Durrës Shqipëri

Tel & fax + 355 52 2 37 859

E-mail alficadex@gmail.com; mariadushi@gmail.com;

Nëse:

Gjithë fondet e përfuara nga personat fizik (përfshirë edhe shtetasit shqiptar me banim jashtë teritorit shqiptar) ose juridik janë marrë sipas përcaktimeve në nenin 89 të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, janë dokumentuar sipas rregullave kontabël dhe janë përdorur në përputhje me kushtet e saktësuara në ligj, konkretisht:

- a. Personat fizik ose juridik që kanë dhënë fonde janë persona vendas me banim brenda ose jashtë teritorit të RSH;
- b. Shuma e dhuruar ose kundravlehtë në sende ose shërbime nga personat fizik ose juridik nuk është më e madhe se 1 (një) milion LEKE;
- c. Nuk janë marrë fonde nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme (përveç rastit kur aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike):
 - ♦ *Neni 89/3.a - Ka përfutuar fonde publike, kontrata publike apo konçensione në 2 (dy) vitet e fundit me vlerë mbi 10 milion LEKE;*
 - ♦ *Neni 89/3.b - Ushtron veprimtari në fushën e medias;*
 - ♦ *Neni 89/3.c - Ka qenë partner me fondet publike në projekte të ndryshme;*
 - ♦ *Neni 89/3.ç - Ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.*

Të gjithë dokumentat mbështetëse regjistri i posaçëm dhe llogaritë janë mbajtur në lidhje me gjithë aktivitetet.

Regjistri është plotësuar sipas përcaktimeve në nenin 90 të ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 (ndryshuar).

Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të lartë se 100 mijë LEKE janë bërë me llogari të pasaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor.

Shpenzimi total i Partisë, përfshirë dhe kandidatët e saj në fushatë nuk e kalon 10/fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marë nga fondet publike sipas nenit 87/3 të Kodit zgjedhor.

Data 24 Tetor 2017



Marije DUSHI - Partner

FICADEX ALBANIA

L. 4, Rr. Migjeni, Durrës



Shtojca A

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare¹

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë auditimit.

Ne gjithashtu:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, përcaktojmë dhe kryejmë procedurat të auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më e lartë se një që rrjedh nga gabimi, duke qenë se mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të duhurat për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.

Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël, nëse ka, dhe informacionet shpjeguese të lidhura të bëra nga drejtimi.

Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet e kryera dhe ngjarjet e ndodhura në një mënyrë që të arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne na kërkohet të komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mesin e çështjeve të tjera, qëllimin e planifikimit dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

¹ Në përputhje me standardet Ndërkombëtare të rishikuara të auditimit (SNA-të/ISAs)

Pasqyra e pozicionit financiar (Bilanci kontabël) (rideklaruar)
Për vitin financiar që përfundon më 31.12.2016 dhe 31.12.2015
Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

Aktivet	Shënime	Periudha nga 1 Janari në:	
		31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
I Aktivet afatshkurtra			
Mjete Monetare dhe ekuivalentët e tyre	6.1.1	18,473,606	5,364,482
Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm	6.1.2	6,058,026	8,838,257
Kontribute të arkëtueshme		-	-
Inventari dhe shpenzime të parapaguara	6.1.3	577,012	763,851
Totali i aktiveve afatshkurtra (I)		25,108,644	14,966,590
II Aktivet afatgjata			
Investime financiare afat gjata	6.2.1	-	-
Aktive të kufizuara për investime në AAGJM	6.2.2	-	-
Toka, ndërtesa dhe paisje	6.2.3	13,821,300	11,140,561
Investime të tjera afat gjata	6.2.4	-	-
Totali i aktiveve afatgjata (II)		13,821,300	11,140,561
Llogari të tjera aktive			
Totali i aktiveve (I+II)		38,929,944	26,107,151
Detyrimet dhe fondet e veta			
I Detyrimet afatshkurtra			
Tituj të huamarrjes	6.3.1	691,200	1,338
Detyrime të pagueshme	6.3.2	127,429,163	126,366,211
Dëftesa të pagueshme	6.3.3	-	-
Kontribute të marra në avancë	6.3.4	-	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		128,120,363	126,367,549
II Detyrimet afatgjata			
Grante	6.4.1	-	-
Premtime të kushtëzuara për të dhënë	6.4.2	-	-
Hua afat gjatë	6.4.3	2,007,501	-
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		2,007,501	-
Totali i detyrimeve I+II)		130,127,864	126,367,549
III Aktivet neto			
Fonde bazë		26,854,184	26,854,184
Rezerva		-	-
Teprica/ (defiçiti) e akumuluar		(132,507,839)	(116,528,993)
Teprica/ (defiçiti) e vitit		14,455,735	(10,585,589)
Totali i fondeve të veta (III)	6.5	(91,197,920)	(100,260,398)
Totali i detyrimeve dhe aktivitet neto (I+II+III)		38,929,944	26,107,151

Dhurata ISUFA
K/Financier



Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet në vijim janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e aktiviteteve (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) (rideklaruar)

Për vitin fiskal që përfundon në 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE

Nr	Përshkrimi i elementëve	Shënime	Periudha nga 1 Janari në	
			31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
I	Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:			
a)	Të ardhurat			
	Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit	7.1.1	11,770,050	38,460,250
	Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	7.1.2	-	18,490,000
	Të ardhura nga grantet Qeveritare apo nga Agjenci të tjera të financimit	7.1.3	73,676,617	90,100,743
	Të ardhura nga investimet apo dhurimet		-	-
	Tarifat për shërbimet		-	-
	Të ardhura nga aktivitetet tregtare	7.1.4	3,577,500	2,429,294
	Të ardhura të tjera		-	-
	Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara (a)		89,024,167	149,480,287
b)	Të ardhura neto të çliruara nga kufizimet			
	Realizimi i kufizimeve të programit		-	-
	Realizimi i kufizimeve për blerjen e pajisjeve		-	-
	Përfundimi i kufizimit të afatit		-	-
	Totali i të ardhurave neto të çliruara nga kufizimet (b)		-	-
	Totali i të ardhurave (I)		89,024,167	149,480,287
II	Shpenzime për aktivitetet			
	Shpenzime për materiale	7.2.1	(1,882,375)	(29,501,518)
	Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	7.2.2	(72,701,413)	(130,564,358)
	Krijim dhe rritje fondesh	7.2.3	-	-
	Totali i shpenzimeve (II)		(74,583,788)	(160,065,876)
A	Rritja/(rënia) në aktivet neto të pakufizuara (I-II)		14,440,379	(10,585,589)
III	Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:			
	Kontributet		-	-
	Të ardhura nga investimet afat gjata		-	-
	Fatimi I realizuar dhe I përealizuar nga investimet afat gjata		-	-
	Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		-	-
	Aktivt neto të çliruara nga kufizimet (-)		-	-
	Rritja/(rënia) në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (III)		-	-
B	Të ardhura/(shpenzime) financiare	7.2.4	15,356	-
	Ndryshimi në aktivet neto (A+B)		14,455,735	(10,585,589)

Dhurata ISUF
K/Financier



Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto (rideklaruar)

Për vitin fiskal që përfundon në 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015
Të gjitha balancat janë në LEKE

"PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE" OJF
Pasqyrat financiare

Nr. Struktura	Fonde bazë	Rezerva rivleresimi	Rezerva të tjera	Shtesë/(paksim) e pashpërndare	Fitim/(humbja) e vitit	Totali
1 Pozicioni financiar më 01 Janar 2015	26,854,184	-	-	(128,298,078)	11,769,085	(89,674,809)
2 Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						
Shtesë/(paksim) e vitit	-	-	-	-	(10,585,589)	(10,585,589)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	(10,585,589)	(10,585,589)
3 Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Shtesë/(paksim) i fondeve të veta	-	-	-	-	-	-
Përdorimi i Shtesë/(paksimit) të mbartur	-	-	-	11,769,085	(11,769,085)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	11,769,085	(11,769,085)	-
4 Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 Dhjetor 2015	26,854,184	-	-	(116,528,993)	(10,585,589)	(100,260,398)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 01 Janar 2016	26,854,184	-	-	(116,528,993)	(10,585,589)	(100,260,398)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						
Shtesë/(paksim) e vitit	-	-	-	-	14,455,735	14,455,735
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	14,455,735	14,455,735
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Shtesë/(paksim) i fondeve të veta	-	-	-	-	-	-
Sistemimi i Shtesë/(paksimit) të mbartur	-	-	-	(5,393,257)	-	(5,393,257)
Përdorimi i Shtesë/(paksimit) të mbartur	-	-	-	(10,585,589)	10,585,589	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	(15,978,846)	10,585,589	(5,393,257)
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2016	26,854,184	-	-	(132,507,839)	14,455,735	(91,197,920)

Dhurata ISQFA
K/Financier



Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (M. Indirekte) (rideklai)

Për vitin Për vitin fiskal që përfundon në 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE

FLUKSET	Shenime	Periudha që përfundon në	
		31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
1 Flukset nga aktivitetet e shfrytëzimit			
Ndryshimet në aktivet neto	PA	14,455,735	(10,585,589)
<i>Rregullime për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me fluksin neto nga aktivitetet e shfrytëzimit:</i>			
Amortizimi dhe zhvlerësimi		829,461	172,826
Humbje të realizuara dhe të porealizuara në investime		-	-
Humbje nga dalja jashtë përdorimit të makineri e paisjeve		37,200	-
Fitim/(Humbje) nga efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të MM		4,116	-
Rritjet/(Rënie) nga interesat bankare		-	-
Rritjet/(Rënie) jo në para nga sistemimi i TVSH		(5,393,257)	-
Kontributet e kufizuara për investime në dhurime/ndihma		-	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afat shkurtër:			
Rritje/(Rënie) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		2,780,231	82,350
Rritje/(Rënie) në shpenzime të parapaguara		-	-
Rritje/(Rënie) në inventarë		186,839	43,369
Rritje/(Rënie) në bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme		-	-
Rritje/(Rënie) në detyrimet e pagueshme		1,752,814	14,935,944
Rritje/(Rënie) në bamirësi mbi baza vjetore		-	-
Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		14,653,139	4,648,900
2 Flukse neto nga aktivitetet investuese			
Blerje/Shitje investimesh		-	-
Blerje/shitje të aktiveve afat gjatë materiale		(3,547,400)	(751,801)
Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme		-	-
Të arkëtuara në avancë nga dëftesat e arkëtueshme		-	-
Flukse neto nga aktivitetet investuese		(3,547,400)	(751,801)
3 Flukse nga aktivitete financiare			
Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		-	-
Principal i paguar për dëftesat e pagueshme		2,007,501	-
Flukse neto nga aktivitetet financiare		2,007,501	-
Rritje/(rënie) neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre		13,113,240	3,897,099
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës		5,364,482	1,467,383
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		(4,116)	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës		18,473,606	5,364,482
Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa			
Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për tatim taksë			

Dhurata ISUFAJ
K/Financier



Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015
Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

1) Informacion i përgjithshëm

“PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, e ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin në Regjistrin e Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 16/1, datë 15.08.1991 me emrin “Partia Socialiste e Shqipërisë” me gërma nistore “PS”.

Në organet tatimore është regjistruar më 29.01.2007 me NIPT: K71329002F

Veprimtaria e Partisë rregullohet me legjislacionin shqiptar në fuqi, dhe kryesisht:

- Ligji Nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike” i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011; ligjin nr. 17/2014, datë 20.2.2014 dhe ligjin nr. 25/2014, datë 25.9.2014;
- “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015;
- Vendime, Udhëzime dhe Akte të tjera të KQZ;
- Ligjit 8788, datë. 07.05.2001 “Per Regjistrimin e Organizatave Jofitimpruese “i ndryshuar me ligjin nr. 92/13, datë 28.02.2013;
- Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me Ligjin Nr. 9477, datë 09.02.2006
- Legjislacioni fiskal dhe akte të tjera ligjore e nënligjore të shtetit Shqiptar.

Selia qendrore e Partisë është deklaruar në adresën: Sheshi “Austria”, Tiranë

Dokumentat bazë dhe simboli,

Partia bazohet ne Programin e saj politik dhe ndërtohet e funksionon në bazë të parimeve e normave, të cilat paraqiten të përmbledhura në Statut. Programi dhe Statuti miratohen nga Kongresi.

Simboli i Partisë Socialiste paraqet një grusht të mbledhur, i cili mban një trëndafil te kuq. Simboli vendoset në vulën, stemën dhe flamurin e partisë.

Stema e Partisë Socialiste është në formë rrethi me ngjyrë të gjelbër, në qendër vendoset simboli i partisë, ndërsa anash tij është shkruar me germa kapitale të bardha PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË 1991.

Flamuri i Partisë Socialiste është ngjyrë rozë me stemën e partisë në mes. Të drejten e përdorimit të simboleve të partisë e kanë vetëm institucionet përfaqësuese të saj në nivel qendror e vendor.

Numri i anëtarëve të Partisë Socialiste deri në 31.12.2016 ka qenë 105 770 anëtarë.

Struktura organizative dhe drejtuese e Partisë

a) Organet vendore

Në nivel Vendor PS ka këtë organizim

Organi Vendor	Nr. fizik
Organizata Socialiste	4 786
Këshilla Socialiste të Njësive Administrative	403
Asamble Socialiste të Bashkive	61
Këshilla Koordinuese te Partisë Socialiste në Qark	12

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

b) Organet Qendrore

Në nivel Qendror PS ka këtë organizim

Organi Qendror	Kompetencat
Kongresi i Partisë Socialiste	Organi më i lartë vendimmarrës i Partisë
Kryetari i PSSH	Drejtuuesi më i lartë politik i Partisë, post të cilin e mban Z. Edi RAMA
Asambleja Kombëtare e PSHSH	Organi më i lartë midis dy Kongreseve

Numri mesatar i punonjësve që kanë punuar për vitin 2016 ka qenë 81

Organe të tjera të zgjedhura nga Asambleja Kombëtare

Kryefinancieri i partisë zgjidhet nga Asambleja Kombëtare me mandate 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Për mbikqyrjen e aktivitetit financiar të Partisë, Asambleja Kombëtare zgjedh Këshillin e Mbiqyrjes financiare të përbërë nga pesë auditues.

Auditimi ligjor

Një herë në katër vjet autorizohet kontrolli financiar mbi financat e partisë nga një firmë auditimi, e listuar dhe e parashikuar si e tillë nga legjislacioni shqiptar. Auditorët e pavarur në mënyrë të veçantë, shprehin një opinion mbi financat, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Audituesi emërohet nga Kryesia e partisë. Raporti i audituesve ligjor i bashkëngjitet raportit të Këshillit të Mbiqyrjes Financiare gjatë paraqitjes së tij në Kongresin e radhës.

Marrëdhëniet me organizatat politike e shoqërore

Forumi Rinor Eurosocialist i Shqipërisë (FRESH) dhe Forumi i Grave Socialiste të Shqipërisë (FGSSH) janë organizma politike përkrahës të PS-së dhe që i asociohen strukturave të saj.

Pranë Partisë Socialiste ngrihet dhe funksionon Fondacioni "Qemal Stafa". Fondacioni "Qemal Stafa" mbështet me burime financiare, njerëzore, institucionale dhe teknike veprimtarinë e Partisë.

Të ardhurat

Burimet financiare¹ të PS-së janë:

- Kuotat e anëtarësisë,
- Subvencionet Shtetërore,
- Dhurimet e ligjshme
- Ndihmat e anëtarëve, përkrahësve dhe votuesëve të Partisë
- Burime të tjera

¹ Në zbatim të Nenit 17, ligji për Partitë Politike dhe 87/1 e në vijim të Kodit Zgjedhor)

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015
Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

2) Kuadri i përgjithshëm për përgaditjen e pasqyrave financiare

a. Paraqitja e pasqyrave financiare të Partisë

Pasqyrat financiare të OJF-ve përbëhen nga:

- pasqyra e pozicionit financiar,
- pasqyra e aktiviteteve, dhe
- pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.

Organizatat jo fitimprurëse japin në shënimet shpjeguese informacione të tjera shtesë të nevojshme për të kuptuar llojin e aktiviteteve dhe shërbimeve që kryejnë.

b. Deklarata e përputhshmërisë dhe objektivit

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo fitimprurëse (OJF), i shpallur nga Ministri i Financave me urdhërin Nr.62, datë 17.09.2015 në mbështetje të pikës 1 të ligjit Nr. 9228 datë 29.04.2004 'Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare', i ndryshuar me ligjin 9477, datë 9 Shkurt 2006 dhe të vendimit Nr. 2, datë 27.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit "Për Miratimin e Standardit Kombëtar të OJF", i detyrueshëm për t'u zbatuar nga data 01 Janar 2016.

Kërkesat e Standardit për OJF-të do të zbatohen në të gjitha pasqyrat financiare të përgatitura nga ato organizata që kanë një identitet ligjor të veçantë, të cilat:

1. Janë krijuar për të kryer aktivitete të veçanta të një natyre bamirëse apo altruiste;
2. Nuk taten (për aq sa nuk kryejnë aktivitet ekonomik fitimprurës);
3. Janë të ndaluara t'i shpërndajnë tepricat nga aktivitetet tek themeluesit dhe/ose anëtarët; dhe
4. Nuk zotërohen ose kontrollohen nga Qeveria.

Objektivi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas këtij Standardi është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës (aktiviteteve) dhe fluksit të mjeteve monetare të Organizatave Jo Fitimprurëse, të dobishëm për qëllime të përgjegjësisë dhe vendimmarrjes së përdoruesve të këtyre pasqyrave financiare (SKK/5).

Qëllimi kryesor i pasqyrave financiare është të ofrojë informacionin e duhur në plotësim të interesave të përbashkëta të donatorëve, anëtarëve, kreditorëve dhe kujtdo pale tjetër, e cila ofron burime për OJF-në. Këta përdorues të jashtëm të pasqyrave financiare kanë interesa të përbashkët në vlerësimin e:

- (a) shërbimeve që organizata ofron dhe aftësisë së saj për të vazhduar me ofrimin e këtyre shërbimeve;
- (b) mënyrës sesi menaxheri delegon përgjegjësitë e tij dhe bashkëpunon me të tjerët; dhe
- (c) aspekte të tjera të performancës së organizatës.

Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës (aktiviteteve) dhe fluksit të mjeteve monetare së OJF-së, vetëm dhe vetëm nëse:

- (a) ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- (b) përgatitja e tyre bazohet në vlerësime të arsyeshme e të bazuara (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme); dhe

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015
Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

2) Kuadri i përgjithshëm për përgaditjen e pasqyrave financiare (SKK 1) (vazhdon)

- (c) shënimet në pasqyrat financiare janë përgatitur me detaje të mjaftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të OJF-së, në mënyrë të tillë që lexuesit kompetentë të mund të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.

Paraqitja e vërtetë dhe e besueshme nënkupton që:

- (a) parimet-bazë dhe kërkesat e tjera, të paraqitura nga neni 9 deri në 12 të Ligjit të Kontabilitetit Nr. 9228, si dhe paragrafët 40-90 të SKK 1 *Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*, janë përdorur si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare të OJF-ve;
- (b) aktivet, detyrimet, aktivet neto, të ardhurat dhe shpenzimet, të paraqitura në pasqyrat financiare të OJF-ve, përmbushin kriteret e përkufizimeve të dhëna në standard.

Kontabiliteti është mbajtur me programin "Alpha", mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

c. Periudhat krahasimore dhe çelja

Të dhënat e periudhave të mëparshme janë të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore. Balancat e mbylljes më 31.12.2015 janë kontabilizuar saktë në çelje 01.01.2016.

d. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjve gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të OJF-së dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nëse SKK për OJF, nuk adreson në mënyrë specifike një transaksion, ngjarje apo rrethanë tjetër, drejtimi i një OJF-je duhet të përdorë gjykimin e vet në zhvillimin dhe zbatimin e një politike kontabël që rezulton në informacion:

- (a) të përshtatshëm për nevojat e vendimmarrjes së përdoruesve; dhe
- (b) të besueshëm, për faktin se pasqyrat financiare:
- (i) përfaqësojnë besnikërisht pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të OJF-së;
 - (ii) përfaqësojnë thelbin e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera, dhe jo thjesht formën ligjore;
 - (iii) janë neutrale, dmth të lira nga paragjykimi;
 - (iv) të matura; dhe
 - (v) të plota në të gjitha aspektet materiale.

Për vitin financiar 2016 PS nuk ka bërë vlerësime kontabël me ndikim material në pasqyrat financiare.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015
Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

2.1. Parimet bazë për përgaditjen e pasqyrave financiare

Supozime dhe konsiderata të përgjithshme

a. Konstatimi i të drejtave / detyrimeve dhe përputhshmëria

Organizatat jofitimprurëse që kanë shifrën e aktivitetit ose shifrën e të ardhurave më të madhe se 5 milionë LEKE, zbatojnë kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuar dhe ndërtojnë të gjitha pasqyrat financiare sipas paragrafit 25 të SKK-së për OJF. OJF-të të cilat nuk plotësojnë këtë kriter zbatojnë kontabilitetin mbi baza monetare dhe ndërtojnë vetëm pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të shoqëruar me shënimet shpjeguese lidhur me llojin e aktivitetit apo shërbimeve që ofron (SKK/26). Pasqyrat financiare të konsoliduara të PS-së janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe jo kur arkëtohen ose paguhen dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.

b. Parimi i njësisë ekonomike

Njësia ekonomike mban llogari të aktiveve, detyrimeve dhe transaksioneve ekonomike të veta të veçanta nga ato të aktiveve, detyrimeve, kreditorëve, punonjësve, klientëve si dhe personave të tjerë. Vetëm aktivet, detyrimet, aktivi neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare të PS-së janë regjistruar në pasqyrat e saj financiare.

c. Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgaditur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e Partisë do të ketë vijimësi dhe Partia nuk ka në plan ose nuk do t'a ketë të nevojshme t'a ndërpresë aktivitetin e saj të paktën për 12 muaj pas datës së pasqyrave financiare.

d. Njohja e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve

Njohja është procesi i përfshirjes në pasqyrat financiare, të një zëri që plotëson përkufizimin e një aktivi, detyrimi, të ardhure ose shpenzimi dhe që plotëson kriteret e mëposhtme:

- (a) është e mundur që çdo përfitim ekonomik në të ardhmen, lidhur me këtë zë, do të rrjedhë për ose nga njësia ekonomike; dhe
- (b) zëri ka një kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri.

Në pasqyrat financiare të Partisë, janë përfshirë zërat që plotësojnë përkufizimin e një aktivi, detyrimi, të ardhure ose shpenzimi.

e. Baza e matjes

Matja me vlerën e drejtë

Çmimet e kuotuarat të tregut, nëse ka të tilla, janë evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të aktiveve monetare ose jomonetare, përfshirë shërbimet. Nëse çmimet e tregut nuk gjenden, vlera e drejtë mund të vlerësohet mbështetur në çmimet e tregut për aktive të ngjashme, çmuarje të pavarura, apo teknika të tjera vlerësimi si p.sh, vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare. Kontributet në shërbime që krijojnë ose shtojnë aktivet jofinanciare mund të maten duke iu referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të marra ose vlerës së drejtë të aktivitetit apo shtesës së tij, si rezultat i shërbimit të marrë. Një pasiguri e qenësishme rreth ekzistencës së vlerës së aktivitetit, mund të çojë në mosnjohjen e një shërbimi të marrë ose të dhënë.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

2) Kuadri i përgjithshëm për përgaditjen e pasqyrave financiare (SKK 1) (vazhdon)

2.1 Parimet bazë për përgaditjen e pasqyrave financiare (vazhdon)

f. Njohja dhe matja fillestare

Kontributet e marra

Kontributet e marra njihen si të ardhura ose fitime në periudhën kur merren dhe si aktive, pakësim të detyrimeve apo shpenzimeve në varësi të formës së përfitimit të marrë. Kontributet e marra maten me vlerën e tyre të drejtë. Kontributet e marra nga OJF paraqiten si ndihma të kufizuara ose të pakufizuara. Kontribute në shërbime do të njihen nëse shërbimet e përfituara (a) krijojnë ose shtojnë aktive jofinanciare ose (b) kërkojnë aftësi të specializuara të ofruara nga individë që i kanë këto aftësi dhe nëse nuk përfitoheshin si donacion do duhej të bliheshin. Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me vlerën e drejtë.

g. Vlerësimi i mëpasshëm

Aktivet dhe detyrimet financiare në vijim, maten me vlerën e drejtë.

Shumica e aktiveve jo-financiare të një njësie ekonomike që fillimisht njihen me kosto historike më pas maten mbi baza të tjera të matjes:

- aktivet afatgjata materiale me koston e amortizuar (ose vlerën e drejtë si një alternativë e lejuar në SKK 5 – Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale);
- inventarët me vlerën më të ulët mes koston dhe çmimit të shitjes minus kostot për të përfunduar shitjen;
- njëh një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me aktivet jo-financiare që janë në përdorim ose mbahen për shitje;

Shumica e detyrimeve, përveç detyrimeve financiare, maten me vlerësimin më të mirë të mundshëm të parashikuar që kërkohet për të shlyer detyrimin në datën e raportimit.

h. Kompensimi

Aktivet / detyrimet dhe të ardhurat / shpenzimet nuk kompensohen me njëra-tjetrën, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet ose lejohet nga SKK-të.

i. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në rritje/(rënie) në aktivet neto të pakufizuara.

Kurset kryesore të këmbimit LEKE/valute janë:

Monedha	31.12.2016	31.12.2015
USD	128.17	125.79
EUR	135.23	137.28
GBP	157.56	186.59

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

2.2. Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare

a. Kuptueshmëria

Informacioni në pasqyrat financiare është paraqitur në mënyrë të tillë që ai të jetë informues dhe për ata përdorues të pasqyrave financiare që kanë njohuri të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit për t'i kuptuar ato. Pasqyrave financiare janë të qarta e të kuptueshme edhe për përdorues të jashtëm, të cilët mund të mos jenë në dijeni të aktiviteteve të përditshme të OJF-së.

b. Rëndësia dhe Materialiteti.

Pasqyrat financiare janë përgaditur mbi bazën e konceptit të materialitetit dhe bazuar në supozimet bazë, parimet dhe karakteristikat e informacionit kontabël. Në përcaktimin e materialitetit janë marrë parasysh aspektet cilësore dhe sasiore të informacionit.

c. Besueshmëria. Informacioni i dhënë në pasqyrat financiare është i besueshëm dhe i lirë nga gabimet materiale.

d. Parimi i paraqitjes me besnikëri. Janë paraqitur me besnikëri transaksionet dhe ngjarjet e tjera që rezultojnë në krijimin e aktiveve dhe detyrimeve për OJF-në në datën e raportimit dhe që plotësojnë kriteret e njohjes.

e. Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore. Për regjistrimin e transaksioneve ekonomike në pasqyrat financiare është marrë në konsideratë përmbajtja e tyre ekonomike, e cila nuk është e thënë që të përputhet gjithmonë me formën e tyre ligjore.

f. Parimi i paanshmërisë. Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare, është i paanshëm, dhe i painfluencuar.

g. Parimi i maturisë. Parimi i kujdesit është përfshirja e një shkalle maturie në ushtrimin e gjykimeve të nevojshme në bërjen e vlerësimeve të kërkuara sipas kushteve të pasigurisë, të tilla që aktivet ose të ardhurat të mos mbivlerësohen dhe detyrimet ose shpenzimet të mos nënvlerësohen.

h. Parimi i plotësisë. Pasqyrat financiare japin të gjithë informacionin e nevojshëm për të paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës (aktiviteteve) dhe flukseve të mjeteve monetare të OJF-së.

i. Qëndrueshmëria dhe krahasueshmëria

Për përgatitjen e pasqyrave financiare janë përdorur vazhdimisht të njëjtat politika kontabël, e njëjta paraqitje dhe të njëjtat formata të pasqyrave financiare.

2.3. Përkufizimet kryesore për elementët e pasqyrave financiare të OJF-ve

Aktivi, është një objekt ose e drejtë ekonomike e kontrolluar nga OJF-ja, i cili

- (a) ka ardhur si rezultat i ngjarjeve të shkuara; dhe
- (b) nga përdorimi, i të cilit priten në të ardhmen përfitime ekonomike ose forma të tjera të mundshme të përfitimeve.

Detyrimet, në pasqyrën e pozicionit financiar të OJF-së janë detyrime aktuale të cilat:

- (a) kanë lindur nga ngjarje të shkuara; dhe

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

2.3. Përkufizimet kryesore për elementët e pasqyrave financiare të OJF-ve (vazhdon)

(b) shlyerja e tyre pritet të shoqërohet në të ardhmen me daljen e përfitimeve ekonomike apo të llojeve të tjera të përfitimeve të mundshme.

Aktivi neto, është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të OJF-së në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Aktivet neto, mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur nga donatori, ndahen në:

- aktive neto të kufizuara, dhe
- aktive neto të pakufizuara;

Aktivitet neto të kufizuara janë burime të kufizuara nga donator/ët. Kufizimet e donatorëve mund të kërkojnë që burimet të përdoren në një periudhë të mëvonshme ose pas një date të caktuar (kufizim në kohë), ose ato burime të përdoren për një qëllim të caktuar (kufizimi i qëllimit), ose të dyja bashkë, p.sh, dhuratat në mjete monetare apo aktive të tjera me përcaktimin që të investohen për të siguruar një burim të ardhurash për një afat të caktuar dhe gjithashtu, kjo e ardhur të përdoret për një qëllim të caktuar. Sa më sipër janë kufizime në kohë dhe në qëllim. Këto dhurata shpesh quhen *dhurata me afat*.

Aktivitet neto të pakufizuara zakonisht janë rezultat i ofrimit të shërbimeve, prodhimit dhe shpërndarjes së mallrave, marrjes së kontributeve të pakufizuara, marrja e dividendëve apo interesave në aktive që gjenerojnë të ardhura, pakësuar me shpenzimet që ndodhin gjatë ofrimit të shërbimeve, prodhimit dhe shpërndarjes së mallrave, krijimit të fondeve dhe realizimit të funksioneve administrative.

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse, gjatë periudhës së raportimit, të përfitimeve ekonomike apo formave të tjera të mundshme të përfitimeve, që rezultojnë në rritjen e aktiveve neto të pakufizuara.

Shpenzimet janë flukse dalëse, gjatë periudhës raportuese, të përfitimeve ekonomike apo formave të tjera të mundshme të përfitimeve, që rezultojnë në pakësimin e aktiveve neto të pakufizuara.

Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë si të ardhurat që lidhen me to. Shpenzimet që lidhen me gjenerimin e përfitimeve ekonomike gjatë periudhave të ardhshme raportuese njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si aktiv kur ato kryhen dhe si shpenzim gjatë periudhës (ave) raportuese kur ato priten të gjenerojnë përfitime ekonomike (për shembull, shpenzimet në aktive afatgjata materiale dhe shpenzimet e amortizimit).

3) Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar ose duhen aplikuar në mënyrë konsistente nga Partia, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe. Ndryshimi në politikat kontabël zakonisht zbatohet në retrospektivë, d.m.th. sikur politika e re të ishte zbatuar gjithnjë. Informacioni krahasues i periudhave kontabël të mëparshme rishihet në mënyrë të tillë që ai të jetë i paraqitur në përputhje me politikën e re kontabël.

a. Instrumenta financiare

Një instrument financiar njihet nëse Partia bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Partisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar. Detyrimi financiar (ose një pjesë të detyrimit financiar) çregjistrohet vetëm kur ai shuhet, (shlyhet, anulohet ose skadon).

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, të tjera investime afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

3) Politikat kontabël (vazhdon)

afatshkurtra. Njohja e mjeteve monetare bëhet me vlerën e drejtë të parasë në datën e transaksionit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e paskontuar të mjeteve monetare të arkëtueshme nga ajo njësi, që është normalisht çmimi i faturës dhe më pas me kosto të amortizuar.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën paskontuar të mjeteve monetare të pagueshme, që është zakonisht çmimi i faturës dhe me pas me kosto të amortizuar.

Hua të marra dhe të dhëna

Huat e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën aktuale të mjeteve monetare të arkëtueshme ndaj dhënësit/ pagueshme ndaj bankës (duke përfshirë pagesat e interesit dhe të principalit). Pas njohjes fillestare, huat e marra dhe të dhëna afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar.

b. Përfitimet e punonjësve

Partia paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Partia nuk operon me ndonjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas pensioni.

c. Aktive afatgjata materiale

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me vlerën neto.

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e vënies në punë. Aktivet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Aktivi	N/A
Ndërtesa - mbi vlerën kontabël neto	5%
Makineri e pajisje- mbi vlerën kontabël neto	20%
Mjete transporti - mbi vlerën kontabël neto	20%
Mobilje dhe orendi - mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike - mbi vlerën kontabël neto	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur duhet të rishikohen në çdo datë raportimi.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

3) Politikat kontabël (vazhdon)

d. Inventari

Inventarët, në njohjen fillestare maten me vlerën e drejtë dhe me pas maten me shumën më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e vlerësuara për përfundimin dhe realizimin e shitjes.

e. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat gjatë rrjedhës normale të aktivitetit maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, duke zbritur kthimet e mundshme. Të ardhurat njihen atëhere kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme janë transferuar tek OJF-ja, marrja e shërbimit është e sigurtë, kostot përkatëse mund të vlerësohen në menyrë të besueshme, si dhe shumat e të ardhurave mund të matet me besueshmëri.

f. Taksimi

Taksimi, në përputhje me legjislacionin fiskal Partitë politike kanë statusin e OJF dhe përjashtohen nga TVSH dhe tatim mbi fitimin, përveç rastit nëse kryen veprimtari të taksueshme. Partia i nënshtrohet taksimit mbi të ardhurat personale dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore.

4) Korigjimi i gabimeve

Gabimet janë mosraportime ose deklarime të gabuara në pasqyrat financiare të një ose më shumë periudhave kontabël, të cilat vijnë nga mospërdorimi ose keqpërdorimi i informacionit të disponueshëm nga drejtuesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Gabime të tilla përfshijnë efektet e gabimeve matematikore, gabimeve në zbatimin e politikave kontabël, paqartësitë apo keqinterpretimet e fakteve, dhe mashtrimet.

Gabimet materiale të periudhave kontabël të mëparshme do të korrigjohen, sipas njërës prej dy mënyrave të mëposhtme:

- Në retrospektivë, që do të thotë se shumata e korrigjimit të një gabimi material, që lidhet me periudhat kontabël të mëparshme, do të raportohet duke rregulluar tepricën e çeljes së kapitalit neto. Informacioni krahasues duhet të riparaqitet, nëse është praktikisht e mundur; ose
- Duke riparaqitur tepricat e çeljeve për aktivet, detyrimet dhe kapitalin e periudhës më të hershme të mëparshme të paraqitur, në rastet kur gabimi ka ndodhur përpara periudhës më të hershme të paraqitur. Gabimet jomateriale duhet të korrigjohen në periudhën kontabël aktuale. Korrigjimi i gabimeve jomateriale në retrospektivë nuk lejohet.

5) Ngjarje pas përfundimit të periudhës raportuese

Nuk ka asnjë ngjarje të ndodhura pas mbylljes së periudhës raportuese, por para datës kur pasqyrat financiare autorizohen për t'u publikuar, që kërkojnë korrigjim të shumave të njohura në pasqyrat financiare apo përshkrim në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për ngjarjet e ndodhura pas publikimit tyre, nëse ato janë materiale.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015
Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

6) Analiza e posteve të pasqyrës së pozicionit financiar

6.1. Aktivet afatshkurtra

6.1.1. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Gjëndja e MM për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Banka	17,627,008	4,920,121
Arka	846,598	444,361
Totali	18,473,606	5,364,482

6.1.1.1. Gjëndjet e aktiveve monetare

Llogaria	LEK	USD	LEK	GBP	LEK	EUR	LEK	Totali/ LEK
BKT	11,719	-	-	-	-	-	-	11,719
CREDINS	17,574,878	292.12	37,441	6.09	960	14.86	2,010	17,615,289
Total 2016	17,586,597	292.12	37,441	6.09	960	14.86	2,010	17,627,008
Total 2015	4,813,674	-	102,389		4,058			4,920,121

6.1.2. Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm

Gjëndja e të drejtave të arkëtueshme për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Klientë të arkëtueshëm	6,020,000	3,420,000
TVSH ²	-	5,393,257
Të tjera të arkëtueshme	38,026	25,000
Totali	6,058,026	8,838,257

6.1.3. Inventarë dhe shpenzime të parapaguara

Gjëndja inventarëve për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Materiale	577,012	763,851
Të tjera në përdorim	-	-
Totali	577,012	763,851

² TVSH e pasqyruar si e arkëtueshme në çelje është sistemuar me aktivet neto (Paksim I mbartur), pasi nuk priten rimbursime nga organet tatimore.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

6.2. Aktive afatgjata

6.2.1. Investime financiare afatgjata

Partia nuk ka investime financiare afatgjata për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

6.2.2. Aktive të kushtëzuara për investime në toka, ndërtesa dhe pajisje

Partia nuk ka aktive të kushtëzuara për investime në toka, ndërtesa dhe pajisje për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015.

6.2.3. Toka, ndërtesa e pajisje

Gjendja e toka, ndërtesa e pajisje për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Ndërtesa	1,643,389	1,643,389
Mjete transporti	3,654,810	691,306
Mobilje e orendi e paisje zyre	3,779,083	3,902,860
Të tjera në përdorim	2,325,541	2,357,241
Paisje informatike e kompjutera	2,418,477	2,545,765
Totali	13,821,300	11,140,561

6.2.3.1. Gjëndja dhe lëvizja e aktiveve AGJM dhe amortizimit

Përshkrimi	Ndërtesa	Mjete trasporti	Mobilje e paisje zyre	Të tjera në përdorim	Paisje Informmat. e kompjutera	Totali
Kosto						
Në 1 Janar 2016	1,643,389	5,737,540	3,902,860	2,357,241	2,545,765	16,186,795
Blerë e krijuar	-	3,456,000 ³	85,900	5,500	-	3,547,400
Paksime	-	-	-	37,200	-	37,200
Bilanci 31 .12. 2016	1,643,389	9,193,540	3,988,760	2,325,541	2,545,765	19,696,995
Amortizimi						
Në 1 Janar 2016	-	5,046,234	-	-	-	5,046,234
Llogaritur për vitin	-	492,496	209,677	-	127,288	829,461
Amortizimi i AAGJM të dala	-	-	-	-	-	-
Bilanci 31.12.2016	-	5,538,730	209,677	-	127,288	5,875,695
Vlera neto e librit						
Në 31 Dhjetor 2016	1,643,389	3,654,810	3,779,083	2,325,541	2,418,477	13,821,300
Në 31 Dhjetor 2015	1,643,389	691,306	3,902,860	2,357,241	2,545,765	11,140,561

³ Me kontratën Nr.491 Rep. Dhe 245 Kol/2 datë 29.02.2016 është blerë një automjet Mercedes Benz me qira financiare me furnizues Autostar Albania dhe qiradhënës "Banka CREDINS" SHA.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

6.2.4. Investime të tjera afat gjata

Partia nuk ka investime të tjera afatgjata për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015.

6.3. Detyrime afatshkurtra

6.3.1. Tituj të huamarrjes

Gjëndja e huamarrjes ASH për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Balanca kreditore e llogarisë likuiduese	-	1,338
Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare	691,200	-
Totali	691,200	1,338

Në çelje në këtë pozicion është pasqyruar gjëndja kreditore e një llogarie likuiduese bankare me vlerë 1,338 (e sistemuar), ndërsa detyrim i vitit është pasqyruar pjesa afatshkurtër e qirasë financiare për blerjen e automjetit.

6.3.2. Detyrime të pagueshme

Gjëndja e detyrimeve afatshkurtra të pagueshme për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të pagueshme ndaj furnitorëve	125,406,078	125,394,571
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,442,274	422,290
TAP (Tatim mbi pagat	580,811	340,850
Tatim në burim	-	208,500
Totali	127,429,163	126,366,211

6.3.3. Dëftesa të pagueshme

Partia nuk ka dëftesa të pagueshme për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

6.3.4. Kontribute të marra në avancë

Partia nuk ka kontribute të marra në avancë për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

6.4. Detyrime afatgjata

6.4.1. Grante

Partia nuk ka marrë Grante AGJ për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015
Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

6.4.2. Premtime të kushtëzuara për të dhënë

Partia nuk ka Premtime të kushtëzuara për të dhënë për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015.

6.4.3. Hua afatgjatë

Gjëndja e huamarrje AGJ për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Hua nga qiraja financiare ⁴	2,007,501	-
Totali	2,007,501	-

6.5. Aktivet neto

Gjëndja e aktivitet neto për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Fonde bazë	26,854,184	26,854,184
Teprica/(defiçiti) i akumuluar	(127,114,582)	(116,528,993)
Teprica/(defiçiti) i sistemuar nga vitet e kaluara ⁵	(5,393,257)	-
Teprica/(defiçiti) i vitit	14,455,735	(10,585,589)
Totali	(91,197,920)	(100,260,398)

6.5.1. Gjëndja dhe ndryshimet në aktivin neto të Partisë

Analiza	Fonde bazë	Teprica/(defiçiti) i akumuluar	Teprica/(defiçiti) i vitit	Totali
Gjëndja në 01.01.2015	26,854,184	(128,298,078)	11,769,085	(89,674,809)
Teprica/(defiçiti) / vitit	-	-	(10,585,589)	(10,585,589)
Përdorimi i tepricë/(defiçitit) të akumuluar	-	11,769,085	(11,769,085)	-
Gjëndja 31.12.2015	26,854,184	(116,528,993)	(10,585,589)	(100,260,398)
Gjëndja në 01.01.2016	26,854,184	(116,528,993)	(10,585,589)	(100,260,398)
Teprica/(defiçiti) / vitit	-	-	14,455,735	14,455,735
Teprica/(defiçiti) i sistemuar nga vitet e kaluara	-	(5,393,257)	-	(5,393,257)
Përdorimi i tepricë/(defiçitit) të akumuluar	-	(10,585,589)	10,585,589	-
Gjëndja 31.12.2016	26,854,184	(132,507,839)	14,455,735	91,197,920

⁴ Shih shënimin nr. 6.2.3

⁵ Shtimi i defiçitit të mbartur me vlerë 5,393,257 LEKE ka ardhur nga sistemimi i TVSH i mbartur nga vitet e kaluara. Sistemimi u bë direkt në aktivet neto (shih shënimin Nr. 6.1.4.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

7) Pasqyra e aktiviteve

7.1. Të ardhurat

7.1.1. Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit dhe burime të tjera të vetat

Të ardhurat nga tarifat e anëtarësimit dhe burime të tjera të vetat për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga tarifat e anëtarësisë	4,558,000	
Të ardhura nga tarifat e rretheve	7,212,050	38,460,250
Totali	11,770,050	38,460,250

7.1.2. Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare

Të ardhurat nga donacionet dhe kontributet vullnetare nga personat fizik dhe juridik për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Financim	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<i>Financime me rrjedhje parash</i>		
Të ardhura nga dhurime në vlera monetare nga persona fizik dhe juridik me vlerë më të madhe se 100 mije LEKE	-	16,940,000
Të ardhura nga dhurime në vlera monetare nga persona fizik dhe juridik me vlerë më të vogël se 100 mije LEKE	-	1,550,000
Financim me rrjedhje parash total⁶	-	18,490,000
<i>Financime pa rrjedhje parash</i>		
Reklama nga mediat publike	-	-
Financime totale nga fonde jo publike	-	18,490,000

Për përfitim të dhurimeve nga stafi i Partisë "PS" njihet mirë legjislacioni, siç trajtohet në vijim:

Se, gjithë fondet e përfuara nga personat fizik (përfshirë edhe shtetasit shqiptar me banim jashtë territorit shqiptar) ose juridik janë marrë sipas përcaktimeve në nenin 89 të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" i miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015; janë dokumentuar sipas rregullave kontabël dhe janë përdorur në përputhje me kushtet e saktësuara në ligj, dhe konkretisht:

- a. Personat fizik ose juridik që kanë dhënë fonde janë persona vendas me banim brenda ose jashtë territorit të RSH;
- b. Shuma e dhuruar ose kundravlefata në sende ose shërbime nga personat fizik ose juridik nuk është më e madhe se 1 (një) milion LEKE;

⁶ Për vitin ushtrimor që përfundon më 31.12.2016 nuk ka të ardhura nga donacionet.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

7.1.2. Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare (vazhdon)

c. Nuk janë marrë fonde nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtëme (përveç rastit kur aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike):

- ' *Neni 89/3.a - Ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo konçensione në 2 (dy) vitet e fundit me vlerë mbi 10 milion LEKE;*
- ' *Neni 89/3.b - Ushtron veprimtari në fushën e medias;*
- ' *Neni 89/3.c - Ka qenë partner me fondet publike në projekte të ndryshme;*
- ' *Neni 89/3.ç - Ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.*

Të gjithë dokumentat mbështetëse regjistri i posaçëm dhe llogaritë duhen mbajtur në lidhje me gjithë aktivitetet sipas përcaktimeve në nenin 90 të Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, konkretisht:

1. Të regjistrohen në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çastin edhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të Kodit dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës e miratuar nga KQZ-ja është nënshkruar në çdo rast dhurimi.
2. Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë LEKE bëet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Çdo shpenzim i kryer dokumentohet dhe kryhet duke respektuar edhe legjislacionin tatimor në fuqi.

7.1.3. Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga Agjenci të tjera të financimit

Të ardhurat nga grantet qeveritare për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Financimi	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Fonde paradhënie të marra nga buxheti i shtetit	73,676,617	90,100,743
Fonde shtesë pas zgjedhjeve	-	-
Financim Total	73,676,617	90,100,743

Financimi nga buxheti i shtetit është bërë me shkresën e Ministrisë së Financave Nr.2222/1, datë 17.02.2016.

Gjithë fondet publike të përftuara në zbatim të nenit 87 të "Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", janë dokumentuar sipas rregullave kontabël dhe përdoren në përputhje me kushtet e saktësuara në ligj.

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

7.1.4. Tarifat për shërbimet, të ardhura nga aktivitete tregtare dhe të ardhura të tjera

Të ardhurat nga tarifat për shërbimet, të ardhura nga aktivitete tregtare dhe të ardhura të tjera për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Financimi	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Tarifat për shërbimet	-	-
Të ardhura nga aktivitete tregtare	-	-
Të ardhura nga qiratë e ambjenteve	3,577,500	2,429,294
Financim Total	3,577,500	2,429,294

Të ardhurat nga qiratë janë realizuar nga qiramarrësit AMC, ORD Dajti dhe Alpha Zeta

7.2. Shpenzimet

7.2.1. Shpenzime për aktivitetet (shpenzime materiale)

Shpenzimet për materiale për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Blerje/Shpenzime materiale	1,716,375	29,501,518
Blerje/shpenzime për vula	166,000	-
Totali	1,882,375	29,501,518

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

7.2.2. Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme

Shpenzimet për administrimin dhe të tjera të përgjithshme për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Shpenzime për - telajo	644,035	-
Shpenzime për blerje energji	1,710,397	1,718,193
Shpenzime për blerje uji	222,244	
Shpenzime për qira	570,000	357,400
Shpenzime për mirmbajtje e riparime	186,760	-
Shpenzime për prime sigurimi	75,425	-
Shpenzime për blerje e shërbime (skenë, podiume, etj...)	1,592,448	-
Shpenzime për foni e ndriçim	5,360,800	-
Shpenzime për shërbim me satelit	464,975	-
Shpenzime për regji	504,000	-
Shpenzime për blerje shërbime tjera nga palët e treta	1,343,164	6,668,211
Shpenzime për auditim	432,000	-
Shpenzime për konsulenca	4,071,253	14,207,736
Shpenzime për udhëtime e dieta	4,271,740	6,701,610
Shpenzime postare dhe për komunikim	2,481,662	1,906,006
Shpenzime për karburant transport	271,700	-
Shpenzime tjera për transport	838,366	6,281,556
Shpenzime për shërbime (komision) bankare	100,637	-
Shpenzime për taksat vendore e doganore	243,582	430,928
Shpenzime për publicitet e reklama	-	44,802,365
Shpenzime për gjoba	76,907	-
Shpenzime për pagat e punonjësve	39,348,769	27,681,249
Shpenzime për Sigurime shoqërore e shëndetësore	4,700,998	2,958,262
Shpenzime për abonime	187,060	-
Shpenzime për pritje e inagurime	2,135,830	16,678,016
Shpenzime amortizimi	829,461	172,826
Vlera kontabël e AAGJM të dala	37,200	-
Totali	72,701,413	130,564,358

Shënime mbi pasqyrat financiare (rideklaruar)

Për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015

Të gjitha balancat janë në LEKE, nëse nuk shprehet ndryshe

7.2.3. Shpenzime për rritje fondesh

Partia nuk ka shpenzime për rritje fondesh për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015.

7.2.4. Të ardhura/(shpenzime) financiare

Rezultati financiar për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga interesat bankare	19,610	
Shpenzime për interesa bankare	(138)	
Humbje nga kursi i këmbimit	3,868	
Humbjet nga kursi i këmbimit	(7,984)	-
Totali	15,356	-

Këto të ardhura neto janë realizuar nga mjetet tona monetare në llogaritë likuiduese dhe vlerësimi i gjëndjes së valutës më 31.12.2016.

Data 05 Tetor 2017

Dhurata ISL
K/Financier



Tabela e fondeve të përftuara nga Partia Socialiste e Shqipërisë prej personave fizik ose juridik vendas

Për vitin fiskal që përfundon në 31 Dhjetor 2016

Të gjitha balancat janë në LEKE

Nr.	Përshkrimi i dhurimit	Vlera në LEKE	Identiteti i plotë i dhuruesit	NIPT-1	Data e dhurimit	Nr. i llogarisë ku u depozitua dhurimi
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						


Dhurata ISUFAJ
K/Financier

